




REPUBLICA E KOSOVË AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY		REPUBLIC OF KOSOVO ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.		Nr. Prot.	
Dep.	2-D/DPK	Prot. No.	01-3840/12
Nr. i faq.		Data	
Broj stranica	02	D. shp.	24-10-2012
Nr. pages		Data	



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 04.10.2012, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I. Mbyllët rasti më nr. AKK-03-3168/12, për z. Hanefi Muharremi, Anëtar i Bordit të Drejtoreve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “ Adem Jashari”, për shkak se zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej, pasi që ka dëshmuar se nuk ushtron më funksion udhëheqës në biznesin e tij privatë pasi që biznesi është shuar.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.1 dhe 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.**

Pas informatës së marre, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokolli AKK-03-3168/12, që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë, z. Hanefi Muharremi, Anëtar i Bordit të Drejtoreve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “ Adem Jashari”.

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si Anëtar i Bordit të Drejtoreve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “ Adem Jashari”, ka qenë i regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve ARBK, si person i autorizuar dhe pronar në biznesin Zyra e Shërbimeve “Eksperti Muharremi” e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 08.08.2012, e ka njoftuar zyrtarin e Lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit

të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejte në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave z. Hanefi Muharremi, ka komunikuar me zyrtarët e Agjencisë dhe e ka konfirmuar se e ka marr shkresën njoftuese dhe dëshiron të njoftohet me detal për situatën që dyshohet për Konflikt të mundshëm të Interesit.

Me datën 24.09.2012, z.Hanefi Muharremi, ka ardhur në zyrat e Agjencisë kundër Korrupsionit për të biseduar lidhur me njoftimin që i kemi bërë për fillimin e hetimeve për Konflikt të Interesit.

Gjate takimit e kemi njoftuar z.Muharremi se për cilën situatë bëhet fjalë, ndërsa ai është shprehur i gatshëm për bashkëpunim, por na ka njoftuar se për çështjen në fjale lidhur me angazhimin e tij në biznes privat ka ndërmarrë hapat e paraparë për të shmangur gjendjen e Konfliktit të Interesit, duke e shuar biznesin në fjalë.

z. Hanefi Muharremi, ka paraqitur dokumentin zyrtarë të lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK), ku dëshmon se biznesi Zyra e Shërbimeve "Eksperiti Muharremi" është shuar me kërkesë vullnetare.

Andaj në bazë të dëshmive dhe fakteve konstatojmë se :

Zyrtari i lartë, z.Hanefi Muharremi, Anëtar i Bordit të Drejtorëve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës " Adem Jashari", nuk gjendet me ne situatën e përshkruar si Konflikt të mundshëm të Interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit Publik pasi që ka bërë shuarjen vullnetare të biznesit ku ishte pronarë dhe person i autorizuar.

Kjo situatë ka paraqitur mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik si Anëtar i Bordit të Drejtorëve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës " Adem Jashari" dhe si person i autorizuar në biznes Private.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

